

VENDIM
Nr. 104, datë 11.2.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 419, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILIN ELEMENT
PËRBËRËS TË PAGËS BRUTO MUJORE TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, dhe të pikave 1, shkronja “a”, e 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, e vendimit nr. 419, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e elementit “paga për gradë” në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave për punonjësit me gradën “Asistent zjarrfikës”, “Zjarrfikës”, “Kryezjarrfikës”, “Nënkomisar zjarrfikës” dhe “Komisar zjarrfikës”, si dhe rezultat i indeksimit në masën 2.5% për gradat e tjera.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i institucioneve përkatëse, të miratuara në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore përballohen nga transfertat e miratuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe nga të ardhurat e veta të njësisve të vetëqeverisjes vendore.

4. Ngarkohen institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

**Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri
dhe Shpëtimin**

Niveli	Grada	Paga për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
Niveli bazë	Asistent Zjarrfikës	65,000	7,000
	Zjarrfikës	69,000	8,000
	Kryezjarrfikës	73,500	8,000
Niveli i mesëm	Nënkomisar zjarrfikës	78,000	6,000
	Komisar zjarrfikës	88,000	6,000
	Kryekomisar zjarrfikës	108,000	6,000
Niveli i lartë	Drejtues Zjarrfikës	118,000	6,000

	Drejtues i Parë Zjarrfikës	143,500	6,000
Niveli madhor	Drejtues i Lartë Zjarrfikës	164,000	6,000